




KOLEGJI - COLLEGE  
**PJETËR BUDI**  
Prishtinë - Prishtina



---

**KOLEGJI "PJETËR BUDI" - PRISHTINË**

**RREGULLORE PËR STUDIMET MASTER**

**Prishtinë, 2020**



Në bazë të nenit 67 të Statutit të Kolegjit "Pjetër Budi", Senati Akademik I Kolegjit, me date 28.12.2020, miratoi kete:

## **RREGULLORE PËR STUDIMET MASTER**

### **I. Dispozitat e përgjithshme.**

#### **Neni 1**

Kjo Rregullore mbi studimet master (në tekstin e mëtejme-Rregullore) përbëhet prej:

- Dispozitat e përgjithshme;
- Organizimi dhe llojet e studimeve;
- Kushtet për regjistrim në studime master;
- Kohëzgjatja e studimeve;
- Ndërrimi i programit – drejtimit të studimeve;
- Kushtet për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit;
- Kushtet e regjistrimit të vitit;
- Provimet, sukcesi në provime;
- Metodatat e vlerësimit të provimeve, notat e studentëve,
- Ankesat – kundërshtimet e studentëve;
- Procedura e përzgjedhjes dhe aprovimit të Temës Master
- Punimi i Temës Master (Master Theses);
- Mbrojtja e Punimit Master;
- Dispozitat Kalimtare dhe të fundit.

### **II. Organizimi dhe llojet e studimeve.**

#### **Neni 2**

3.1. Kolegji "Pjetër Budi" organizon studime të rregullta master për fitimin e gradës shkencore në lëmenjtë e përcaktuar me planin dhe programin mësimor të studimeve master, në përputhje me vendimin për akreditim nga Agjencioni për Akreditim i Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

3.2. Kolegji "Pjetër Budi" mund të organizojë studimet master dhe në bashkëpunim me fakultetet tjera të Universiteteve tjera jashtë vendit, mbi bazën e programeve të përbashkëta të studimeve dhe memorandumeve për partneritet.

#### **Neni 3**

4.1. Studimet master kanë të drejtë t'i regjistrojnë të gjithë studentët të cilët i kanë kryer studimet themelore (bachelor) dhe kanë fituar së paku 180, përkatësisht 240 kredi (ECTS).



4.2. Në studimet master kanë të drejtë të regjistrohen edhe kandidatët të cilët studimet themelore i kanë kryer jashtë vendit e të cilat njihen nga EUA (Shoqata e Universiteteve Evropiane) ose institucioni i cili është pranuar nga një agjenci ndërkombëtare e akreditimit.

#### **Neni 4**

5.1. Të drejtën e dhënies së mësimit master e ka personeli mësimor në thirrje të profesorit (profesor i rregullt, profesor i asocuar dhe profesor asistent) i cili i plotëson kushtet e parapara me statutin e Kolegjit "Pjetër Budi". Të drejtën e mbajtjes së ushtrimeve, seminareve në studimet master e kanë edhe asistentët me së paku titullin e magjistraturës ose diplomë ekuivalente me të.

5.2. Në raste të caktuara në një lëndë mësimore mund ta mbajnë mësim dy ose më shumë mësimdhënës. Në rastin kur mësimin e mbajnë më shumë mësimdhënës në indeks shënohet emri i bartësit të lëndës.

#### **Neni 5**

6.1. Të drejtën e organizimit të studimeve master, sipas vendimit nr.561/2014 të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, e kanë këto Programet Studimore:

6.1.1. Programi Studimore: Doganë dhe Shpediton Master

6.1.2. Programi Studimore: Menaxhment Master, me dy nën profile

6.1.2.1. Master në Menaxhimin e Turizmit dhe Hotelerisë,

6.1.2.2. Master në Menaxhimin e Sigurimeve.

6.2. Kolegji "Pjetër Budi" organizon studime Master edhe në programe tjera, në bazë të vendimit për akreditim nga Agjencia Kosovare e Akreditimit.

#### **Neni 6**

7.1. Studimet master i udhëheq kolegji i studimeve master. Kolegji përbëhet prej 5 anëtarëve - mësimdhënësve të cilët janë të angazhuar në realizimin e programeve studimore-master në departamentet gjegjëse. Anëtarët e Kolegjiut zgjidhen nga ana e Këshillit Mësimor – Shkencor të Kolegjit.

7.2. Listën e mësimdhënësve për realizimin e programit në studimet master e propozon Kolegjiut i studimeve master dhe e aprovon Senati Akademik.

7.3. Kolegjiut i studimeve master e udhëheq kryetari i Kolegjiut për studimet master.

#### **Neni 7**

Mësimi realizohet në formë të ligjëratave, seminareve, ushtrimeve teorike, punës praktike dhe punës në terren, ekskursioneve profesionale dhe shkencore – mësimore, diskutimeve, konsultimeve profesionale dhe nëpërmes punimeve të pavarura të studenteve, si dhe punimit përfundimtar (diplomës) për arritjen e gradës master.

### **III. Kushtet e regjistrimit në studime**

#### **Neni 8**

9.1. Kolegji "Pjetër Budi", regjistron studentë sipas mundësive kadrovike e teknike, të nevojave të shoqërisë dhe tregut për profile shkencore deficitare.

9.2. Propozimin për regjistrimin e studentëve të rinj e jep departamenti përkatës dhe e miraton Këshilli i Kolegjit.

9.3. Vendimin përfundimtar mbi shpalljen e konkursit publik e bën Bordi Drejtues i Kolegjit "Pjetër Budi".



#### **Neni 9**

10.1. Të drejtë regjistrimi në studimet master në Kolegjin "Pjetër Budi" kanë të gjithë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet baçelor me 180 ose 240 ECTS kredi.

10.2. Studentët të cilët kanë përfunduar studimet baçelor me sistem 4 vjeçar (240 ECTS kredi) u pranohen 60 ECTS kredi të fituara paraprakisht dhe transferohen direkt në semestrin e 9 në Kolegjin "Pjetër Budi" në drejtimin përkatës.

10.3. Pranimi i këtyre kredive ju llogaritet si mësimnxënie.

10.3. Për kandidatët e paraqitur për regjistrim të cilët kanë përfunduar studimet baçelor në drejtime jo adekuate me programet studimore të cilat i ofron Kolegji "Pjetër Budi" do të organizohen provime shtesë (diferenciale) nga formimi baza i drejtimit përkatës.

10.4. Provimet plotësuese caktohen me vendim nga Kolegjiumi i studimeve master.

10.5. Semestrat në studimet Master llogaritën si semestri 1, 2, 3 dhe 4 për studentët të cilët kanë arritur 180 ECTS kredi në ciklin e parë të studimeve, ndërsa për Studentët të cilët në ciklin e parë të studimeve kanë arritur 240 ECTS kredi, llogaritet semestri i 3, dhe 4.

#### **Neni 10**

Regjistrimi i studentëve në semestrin e parë në studimet master bëhet nga Administrata e Kolegjit "Pjetër Budi", kurse indeksin e studentit e nënshkruan Rektori i Kolegjit "Pjetër Budi".

#### **Neni 11**

12.1. Me rastin e konkurrimit kandidatët duhet të sjellin këto dokumente :

- Diplomën Baçelor origjinal ose kopje të vërtetuar, përkohësisht mund të pranohet edhe certifikata e kryerjes së studimeve baçelor;
- certifikatën e notave;
- certifikatën e lindjes;
- dy (2) fotografi ( formati 4,5 x 6cm),
- plotësimi i formularit për regjistrim.

12.2. Dokumentet e dorëzuara nga studenti me rastin e regjistrimit mbeten në shërbimin e studenteve. Shërbimi i studentëve bën regjistrimin e studentëve të rinj në librin amzë, në programin e veçantë në kompjuter dhe formon dosjen e studentit.

### **IV. Ndërrimi i programit – drejtimit të studimeve**

#### **Neni 12**

Për ndërrimin e programit të studimit ose transferimit prej një Programi Studimor në tjetrin të Kolegjit "Pjetër Budi" ose nga ndonjë Universitet tjetër jashtë vendit në Kolegjin "Pjetër Budi", vlejné dispozitat e parapara me Statutin e Kolegjit "Pjetër Budi" dhe Rregullores relevante.

### **V. Kohëzgjatja e studimeve**

#### **Neni 13**



- 14.1. Studimet master zgjasin 2 vite akademike përkatësisht 4 semestra, dhe në çdo semestër me dhënien e provimeve fitohen nga 30 ECTS, ndërsa në semestrin e fundit studenti është i obliguar të mbrojë Temën master, qe do të thotë se për përfundimin e këtyre studimeve duhet të arrihen 120 kredi të ECTS.
- 14.2. Studenti me kushte të përcaktuara me Statutin e Kolegjit e ruan statusin e studentit të rregull të edhe për dy vite të tjera.
- 14.3. Fillimi dhe mbarimi i semestrave mësimor bëhet sipas dispozitave të Statutit të Kolegjit "Pjetër Budi".
- 14.4. Mësimi në studimet master zhvillohet në 15 javë për një semestër.

## **VI. Kushtet për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit**

### **Neni 14**

- 15.1. Personi i regjistruar në Kolegjin "Pjetër Budi" e ka statusin e studentit të rregullt. Statusi i studentit dëshmohet me indeks ose me ndonjë dokument ekuivalent.
- 15.2. Në rast të humbjes së indeksit me lejen e Rektori të Kolegjit studentit i lëshohet "indeksi duplikat". Kërkesës për indeks duplikat duhet t'i bashkëngjitet dëshmia se indeksi është shpallur i pavlefshëm dhe se është bërë pagesa sipas rregullores.
- 15.3. Kushtet për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit janë të rregulluara me Statutin e Kolegjit "Pjetër Budi".
- 15.4. Këshilli i Kolegjit i përjashton nga Kolegji përkohësisht ose përgjithmonë studentët të cilët i shkelin rregullat e përcaktuara me Rregulloren për procedurën disiplinore të Kolegjit "Pjetër Budi"

## **VII. Kushtet e regjistrimit të vitit**

### **Neni 15**

Senati Akademik i Kolegjit me vendim të veçantë përcakton kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studentëve.

## **VIII. Provimet dhe sukcesi në provime**

### **Neni 16**

- 17.1. Studentët janë të obliguar dhe kanë të drejtë të paraqesin dhe të japin provime. Provimet jepen nga të gjitha lëndët e parapara me planin mësimor të studimeve, pas përfundimit të mësimit të lëndës përkatëse. Studenti fiton të drejtën t'i nënshtrohet provimit nga një lëndë pasi t'i kryej obligimet që parashihen me programin mësimor.
- 17.2. Provimet mbahet me shkrim, me gojë ose me shkrim dhe me gojë. Kur provimi përbëhet prej pjesës me shkrim dhe me gojë, studenti mund të hyjë në provim me gojë, vetëm atëherë kur në pjesën me shkrim ka marrë notën pozitive.
- 17.3. Për përcaktimin e suksesit akademik të studentit, mund të aplikohen edhe këto forma pune: Kollokiumi, punimi seminarik, testi dhe ushtrimet praktike.
- 17.4. Studenti ka të drejtë t'i nënshtrohet provimit të njëjtë tri (3) herë. Nëse edhe herën e tretë nuk e kalon provimin, duhet t'i nënshtrohet provimit para komisionit.
- 17.5. Nëse profesorët e lëndëve nuk i obligojnë të punojnë punime seminarike, studenti është i detyruar të punojë nga një punim seminarik për çdo semestër në të cilin mbahen ligjëratat. Studenti vet përcaktohet se



në cilën lëndë do ta marrë punimin seminarik. Tema e punimit seminarik shënohet në indeks nga profesori i lëndës.

#### Neni 17

- 18.1. Kolegji "Pjetër Budi" – Prishtinë, brenda një viti akademik organizon tri (3) afate të rregullta të provimeve.
- 18.2. Afate të rregullta të provimeve janë: afati i janarit, afati i qershorit dhe afati i shtatorit.
- 18.3. Sipas nevojës dhe me kërkesë të studentëve, Kolegji "Pjetër Budi", mund të organizojë afate shtesë të provimeve për studentë.
- 18.4. Provimet organizohen në secilën lëndë për secilin Program Studimor në kuadër të Kolegji "Pjetër Budi" – Prishtinë

#### Neni 18

- 19.1. Pas publikimit të njoftimit për organizimin dhe orarin e mbajtjes së provimeve i cili njoftim duhet të bëhet të paktën 5 ditë para organizimit të provimit të parë të afatit, studentët janë të obliguar që në afatet e parapara kohore, brenda afatit të përcaktuar me vendim nga Rektori, të paraqesin provimet, të cilave janë të gatshëm t'iu nënshtrohen.
- 19.2. Studenti me rastin e paraqitjes së provimit, duhet ta posedojë indeksin si dhe ta ketë semestrin vijues të regjistruar – vërtetuar, varësisht nga afati i paraqitjes së provimit.
- 19.3. Studenti mundet të paraqesë provimin edhe pas kalimit të këtij afati të rregullt, mirëpo më së voni 24 orë para datës së mbajtjes së provimit.
- 19.4. Provimet e paraqitura jashtë afatit të rregullt, me vendim të posaçëm të Këshillit Mësimor Shkencor, janë me pagesë dhe shuma përcaktohet nga Rektori i Kolegjit "Pjetër Budi" — Prishtinë.
- 19.5. Studenti, i cili nuk e ka paraqitur me kohë provimin, nuk mundet të hyjë në provim.
- 19.6. Studentët paraqitjen e provimeve brenda afatit të paraparë nga administrata e bëjnë pa pagesë. Mirëpo në rast se studenti nuk e kalon provimin në dy tri (3) apo nuk e paraqet provimin në tri (3) afate, në afatin e katërt (4) duhet të paguaj taksen prej 20 eurove.

#### Neni 19

- 20.1. Për përcaktimin e notës përfundimtare të testit vlerësues të provimit për studentë do të aplikohen këto metoda të vlerësimit:
  - 20.1.1. 100 pikë provimi final me shkrim, me gojë, në formë të eseve apo plotësimit të testit, me të cilin bëhet vlerësimi përfundimtar i njohurive nga lënda përkatëse.
  - 20.1.2. mësimdhënësi i lëndës ka të drejtë që ta vlerësojë studentin me notë me të lartë se ajo e fituar në testin e vlerësimit, duke u bazuar në aktivitetin e studentit gjatë ligjëratave, si dhe duke u bazuar në punimin, dhe prezantimin e punimeve seminarike.

#### Neni 20

- 21.1. Testin vlerësues të provimit e përgatit mësimdhënësi i lëndës. Me test mund të merren/fitohen maksimum 100 pikë.
- 21.2. Mësimdhënësi i lëndës mund të organizoj edhe ndonjë formë tjetër të testit vlerësues nëse mendon se do të jetë më e dobishme për vlerësimin e njohurive të studentëve.
- 21.3. Mësimdhënësi i lëndës duhet të përfshijë në syllabusin e lëndës metodologjinë e vlerësimit dhe tua komunikojë studentëve në fillim të ligjëratës së parë.
- 21.4. Studenti e kalon provimin nëse në testin vlerësues të provimit ka mbi 50 pikë.



21.4. Përcaktimi i notës përfundimtare të testit vlerësues të provimit bëhet në këtë mënyrë:

- Prej 50 - 59 pikë merret nota 6 (gjashtë)
- Prej 60 - 69 pikë merret nota 7 (shtatë)
- Prej 70 - 79 pikë merret nota 8 (tetë)
- Prej 80 - 89 pikë merret nota 9 (nëntë)
- Prej 90 - 100 pikë merret nota 10 (dhjetë).

#### Neni 21

22.1. Në të gjitha programet studimore të Kolegjit "Pjetër Budi" – Prishtinë, për të përcaktuar nivelin e suksesit të studentit, do të aplikohen këto nota:

| Nr. | Nota/me numra | Vlerësimi me shkrim |
|-----|---------------|---------------------|
| 1.  | 10            | shkëlqyeshëm        |
| 2.  | 9             | shkëlqyeshëm        |
| 3.  | 8             | shumë mirë          |
| 4.  | 7             | mirë                |
| 5.  | 6             | Mjaftueshëm         |
| 6.  | 5             | pamjaftueshëm       |

22.2. Studenti konsiderohet se ka kaluar me sukses provimin nëse është vlerësuar me notën nga 6 deri në 10, ndërsa konsiderohet se nuk e ka kaluar provimin nëse është vlerësuar me notën 5 (pesë).

#### Neni 22

23.1. Mësimdhënësi i lëndës, pas përfundimit të provimeve, i kontrollon testet vlerësuese të provimeve, të cilat duhet të kontrollohen brenda 48 orëve, nëse nuk kontrollohen testet brenda 48 orëve, atëherë testet i kontrollon komisioni i caktuar nga Kolegjit "Pjetër Budi". Testet duhet të kontrollohen në ambientet e Kolegjit "Pjetër Budi" – Prishtinë.

23.2. Pas kontrollimit të testeve vlerësuese, mësimdhënësi i lëndës i nënshkruan listat përfundimtare të notave.

23.3. Shpallja e listave me rezultatet përfundimtare të provimeve bëhet në tabelat e njoftimeve të Kolegjit "Pjetër Budi", me ç'rast studentët njoftohen për rezultatet e provimeve.

### IX. Ankesat kundërshtimet e studentëve

#### Neni 23

24.1. Nëse studentit nuk është i kënaqur me notën e arritur në bazë të vlerësimit të testit të njohurive në provim, apo provimit me gojë, atëherë ai ka të drejtë të parashtojë kërkesë me shkrim për refuzimin e notës së marrë në lëndën përkatëse.

24.2. Kërkesa i drejtohet mësimdhënësit të lëndës, në afatin kohor prej 2 ditësh apo 48 orësh nga momenti i shpalljes së rezultateve të provimeve.

24.3. Pas refuzimit të notës, studentit duhet t'i nënshtrohet provimit në afatin vijues.

#### Neni 24



25.1. Studenti i pakënaqur me rezultatet e testit vlerësues të provimit apo provimit me gojë dhe me notën përfundimtare të provimit, ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim, për të kontrolluar testin vlerësues të provimit.

25.2. Kërkesa i drejtohet mësimdhënësit të lëndës përkatëse duke e informuar edhe Rektorin e Kolegjit.

25.3. Pas paraqitjes së kërkesës, studenti mundet të kontrollojë testin vlerësues të provimit, në prani të mësimdhënësit të lëndës përkatëse, ose të Rektorit dhe t'i shohë gabimet e tij gjatë plotësimit të testit vlerësues të provimit.

#### **Neni 25**

26.1. Studenti ka të drejtë të parashtrojë ankesë me shkrim kundër notës së marrë në lëndën përkatëse dhe të kërkojë të formohet komisioni i posaçëm për provim.

26.2. Ankesa i drejtohet Rektorit të Kolegjit, në afatin kohor prej 2 ditësh apo 48 orësh nga momenti i shpalljes së rezultateve të provimeve.

26.3. Në ankesë studenti duhet të arsyetojë pakënaqësinë me rastin e vlerësimit të testit me shkrim apo të provimit me gojë.

26.4. Pas marrjes së ankesës, Rektori, e në raste të posaçme edhe Senati Akademik, e formon komisionin e posaçëm të provimit dhe emëron 3 anëtarë për vlerësim, dhe e lajmëron mësimdhënësin e lëndës, i cili ka të drejtë të marrë pjesë gjatë vlerësimit të studentëve nga Komisioni në cilësinë e vëzhguesit.

26.5. Rektori pas formimit të Komisionit cakton datën e vlerësimit e cila nuk mund të jetë më e largët së katër ditë dhe më e afërt se dy ditë nga parashtrimi i kërkesës nga studentit për vlerësim nga komisioni.

### **X. Procedura e përzgjedhjes dhe aprovimit të Temës Master**

#### **Neni 26**

27.1. Studentët pasi të përfundojnë provimet dhe t'i jenë pranuar punimet seminarike, paraqesin kërkesë për aprovimin e temës Master.

27.2. Për lejin e temës së Masterit kandidati paraqet kërkesë me shkrim në Kolegjiumin e Studimeve Master. Në kërkesë kandidati paraqet: Titullin e temës, arsyeshmërinë e zgjedhjes së temës, qëllimin e hulumtimit, kontributin shkencor, rezultatet e pritura, metodat e studimit, projektin hulumtues, si dhe propozimin për Mentor.

#### **Neni 27**

28.1. Pas paraqitjes së kërkesës për aprovimin e temës master bëhet verifikimi i dosjes së kandidatit.

28.2. Verifikimin e dosjes së kandidatit e bën komisioni i përhershëm në Kolegjin "Pjetër Budi", në këtë përbërje: 1. Rektori i Kolegjit, 2. Menaxheri ekzekutiv, dhe 3. Drejtori i financave.

28.3. Pas verifikimit të dosjes komisioni merr vendim dhe konstaton a është e kompletuar dosja e kandidatit apo jo.

#### **Neni 28**

29.1. Nëse dosja e kandidatit është e kompletuar atëherë Kolegjiumi për studimet master e vlerëson kërkesën e kandidatit dhe merr vendim për aprovimin dhe lejin e temës Master të kandidatit përkatës, në të cilin vendim përcaktohet edhe Mentori i kandidatit dhe komisioni vlerësues.





29.2. Kolegjiumi ka të drejtë të refuzojë kërkesën për aprovimin e temës, të bëjë riformulimin e emërtimit të temës pa ja ndryshuar përmbajtjen e temës, ose edhe të kërkojë nga kandidati të bëjë riformulimin e emërtimit;

29.3. Tema e propozuar duhet të jetë punimi i ri dhe të ketë rëndësi për shkencën në vend, dhe nuk duhet të jetë mbrojtur nga studentët tjerë në Kolegj për të paktën 5 vite.

#### **Neni 29**

30.1. Mentori është i obliguar t'i ndihmojë kandidatit me sugjerime, udhëzime, këshilla deri në përfundimin e temës Master.

30.2. Mentori mban evidencë për takimet dhe rekomandimet, sugjerimet të cilat i ka parashtruar kandidatit të tij.

30.3. Mentori duhet të ketë gradë shkencore Doktor i shkencave përkatëse.

30.4. Komisioni për vlerësimin e temës master, i paraqet raport Këshillit mësimor – shkencor për plotësimin e kushteve metodologjike – shkencore, për mbrojtjen e temës master të kandidatit.

30.5. Pasi të aprovohet raporti nga Senati Akademik i Kolegjit, komisioni në konsultim me kandidatin cakton datën e mbrojtjes publike.

### **XI. Punimi i temës master – teza për master**

#### **Neni 30**

Studimet master në Kolegjin “Pjetër Budi” përfundojnë me punimin dhe mbrojtjen e punimit master në pajtim me programin e studimeve.

#### **Neni 31**

Punimi master – teza master paraqet punim të pavarur shkencor të kandidatit me të cilin ai tregon që ka përvetësuar njohuri dhe mund të parashtrrojë dhe të zgjidh probleme dhe detyra profesionale – shkencore.

#### **Neni 32**

Punimi për master elaborohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimeve mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve komplekse kërkimore në fushën shkencore për të cilën është përcaktuar studenti.

#### **Neni 33**

34.1. Punimi i diplomës për master mund të elaborohet vetëm nga një studentë – individualisht.

34.2. Punimi i masterit duhet të përmbajë 41 deri në 50 faqe të formatit A4.

34.3. Punimi i Masterit duhet të dorëzohet në shërbimin për studimet master të Kolegjit në 6 kopje identike të radhitura në kompjuter në formatin A4, me llojin e shkrimit Times New Roman, me margjinat 2.5 cm. me rrallësi në mes të rreshtave 1.5. dhe madhësinë e shkronjave 12.

34.4. Nëse Studenti dëshiron ta zgjerojë temën duhet të bëjë kërkesë në Këshillin mësimor shkencor për lejimin e zgjerimit të temës, në aspektin e përmbajtjes dhe volumit.

#### **Neni 34**

Pjesët e domosdoshme të punimit master janë:

a.) Kopertina, e cila përmban shënimet:



- 
1. Kolegji "Pjetër Budi", Programi studimor përkatës,
  2. Punim Masteri,
  3. Titulli i Temës Master
  4. Emri dhe mbiemri i kandidati,
  5. Titulli dhe grada shkencore së bashku me emrin dhe mbiemrin e mentorit,
  6. Prishtinë, viti.
- b.) Faqja e dytë përmban shënimet:
1. shënimet nga pika a).
- c.) Pjesët e tjera të punimit:
1. Përmbajtja, 2. hyrja, 3. arsyetimi i temës dhe metodologjia e punës, 4. shtjellimi i temës, 5. përfundimi, 6. lista e akronimeve dhe shkurtesave, dhe 7. bibliografia.

## **XII. Mbrojtja e Punimit Master**

### **Neni 35**

- 36.1. Data dhe vendi i mbrojtjes duhet të shpallet së paku 3 ditë para mbrojtjes. Mbrojtja e temës master bëhet publikisht.
- 36.2. Kryetari i komisionit e hap seancën për mbrojtjen publike të punimit të masterit, dhe paraqet të dhënat lidhur me procedurën e zhvilluar deri në nxjerrjen e vendimit mbi lejimin e mbrojtjes të punimit si dhe paraqet të dhënat biografike dhe bibliografike të kandidatit. Mentori në pika të shkurtra e paraqet raportin e komisionit për vlerësimin e punimit të masterit.
- 36.3. Kandidati bënë një prezantim – paraqitje të përmbledhur të punimit, por jo më gjatë se 30 minuta.
- 36.4. Mbrojtjen e udhëheq kryetari i komisionit. Kryetar i komisionit nuk mund të jetë mentori. Pas leximit të raportit të komisionit dhe parashtrësës së kandidatit, pasojnë pyetjet e anëtarëve të komisionit dhe përgjigjet e kandidatit, si dhe fjala përfundimtare e kryetarit të komisionit.
- 36.5. Pas përfundimit të mbrojtjes, komisioni tërhiqet për të marrë vendim. Vendimi merret njëzëri ose me shumicë votash.
- 36.6. Studenti që e mbron me sukses temën e Masterit merr gradën shkencore "Master i Arteve", sipas drejtimit përkatës të studimeve.
- 36.7. Pas fitimit të gradës shkencore master, kandidati nga shërbimi përkatës i Kolegjit "Pjetër Budi" merr certifikatën diplomimit (e cila mund të përdoret perkohësisht në vend të diplomës) e nënshkruar nga Rektori, në afat optimal studentit pajiset edhe me diplomën e nënshkruar nga Rektori, të vulosur me vulë të thatë dhe të protokolluar në librin amë të të diplomuarve.
- 36.8. Kolegji "Pjetër Budi" mban evidencën e studentëve të diplomuar në studimet master.

## **XIII. Dispozitat shfuqizuese dhe kalimtare**

### **Neni 36**

- 37.1. Kjo rregullore me propozimin Rektori aprovohet nga Senati Akademiki Kolegjit "Pjetër Budi" – Prishtinë.
- 37.2. Dispozitat me të cilat është ndryshuar dhe plotësuar kjo Rregullore janë inkorporuar direkt në Rregullore dhe nuk i janë bashkëngjitur si amendamente.



37.3. Nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen të gjitha dispozitat tjera të cilat e rregullojnë materien e njëjtë të cilën e rregullon kjo Rregullore.

37.4. Për rastet të cilat ka filluar procedura sipas dispozitave të Rregullores paraprake vlejné dispozitat e Rregullores së vjetër.

### Neni 37

38.1. Kjo Rregullore përmban 37 nene dhe hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati Akademik i Kolegjit "Pjetër Budi" dhe nënshkrimit nga Rektori.

38.2. Për të gjitha çështjet tjera mbi të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës dhe Statutit të Kolegjit "Pjetër Budi".

38.3. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje mund të bëhen sipas procedurës me të cilën është miratuar.

  
Rektori i Kolegjit  
**Prof.Ass.Dr. Artan Haziri**

